

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS  
SEKSIONI PËR PERHAPJEN E NJOHURIVE TEKNIKO - SHKENCORE

*H. Ceka*

# APOLLONIA

15  
6

60-63

TIRANË, 1958

913  
Co 33

32033  
~~24102~~  
BIBLIOTEKË E SHIETI  
GJIROKASTER

# APOLLONIA



N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1958

24702

1000

APOLLONIA



## APOLLONIA

Një ndër qytetet më të lashtë dhe më të rëndësishëm të vëndit tonë, ka qënë Apollonia. Ky qytet i themeluar më se njëzet e pesë shekuj më parë (në vjetin 1966 kishte për të festuar 2550 vjetorin) nuk është më. Sipërfaqen e kodrës, mbi të cilën ngrihej dikur qyteti më i madh dhe qendra kulturele më e rëndësishme e bregut lindor t'Adriatikut, e mbulojnë sot pjesërisht ara drithi të mbushura me një lemeri të madhe copash tjegullash, pjesërisht e lëndina plot ferra e kaçube. Vetëm disa gërmadha të paka, dëshmitë e vetme të jetës dhe të madhështisë së dikurshme të qytetit, shifen aty këtu mbi këtë kodër, që ngrihet në jugë-lindje të fshatit Pojan të Fierit ose fshihen ende në tokë e presin të zbulohen nga kazma e arkeologut

Kodra, mbi të cilën ngrihej qyteti i Apollonisë bën pjesë në vargun e lartësive të Maliakastrës, që zgjaten në drejtim të veri-perëndimit për nga deti, por shkrihen në fushë shumë kilometra para se të arrijnë brigjet e Adriatikut. Nga Fieri Apollonia është vetëm 10 km. larg, kështu që në stinën e verës mund të vizitohet fare lehtë edhe me këmbë. Për këtë qëllim mjafton të ndiqet udha Fier-Seman deri tek ferma «Çlirimi». Së këtejmi merret udha e fshatit Radostinë, që duket në krahun e majtë; për një gjysëm ore arrihet mandej në godinën e manastirit të Shëmrisë, ku është vendosë muzeu, që përmbledh në gjirin e tij shumë nga sendet arkeologjike të gjetura në vazhdim të gërmimeve. Vizituesit i pret këtu një guidë, një udhëheqës, që e ndihmon dhe i shpjegon atij qoftë monumentet arkeologjike të zbuluara në gërmimet, qoftë sendet e ekspozuara në muze. Me automjet Apollonia mund të vizitohet në çdo kohë e stinë nga ana e Levanit (mbi rrugën Fier Vlorë) nja 10 km. larg nga qyteti i parë, kurse në verë rruga mund të shkurtohet duke ndjekur rrugën Fier-Seman në drejtim të fshatit Pojan.

Megjithëse në vijë të drejtë ndodhej afër tetë kilometra larg bregdetit, Apollonia ishte liman dhe lidhej me Adriatikun nëpërmjet të lumit të Vjosës, i cili ato kohë rridhte pranë qytetit dhe u lejonte anijeve të hidhnin hekurat e tyre vetëm 1800 m. larg mureve të tij.



Prej banorëve të parë, që ishin helenë nga origjina, qyteti u quajt Apollonia, në shënjë falënderimi kundrejt perëndisë Apollon, i cili, si mbrojtës i bujqësisë dhe blegtorisë, ishte njëkohësisht edhe mbrojtës i kolonistëve. Për rreth Apollonisë banonte fisi i fuqishëm ilir i Taulantëve, pa pëlqimin e të cilëve kolonistët helenë, që u ngulën për herë të parë këtu dhe themeluan qytetin, nuk do të kishin mundur të qëndronin. Ngritja e qytetit në mes të një krahine të pasur të banuar nga ilirët siç ishte kjo pjesë e Myzeqesë, që kufizohet me Mallakastrën le të kuptojsh se helenët e parë, që ranë në kontakt me popullsinë vëndëse, kishin qëllime thjesht tregëtare, gjë, që ishte në interesin e të dy palëve. Me forcimin e mëtejshëm të qytetit me kolonistë të tjerë erdhën edhe një tok zanatlinj, por edhe bujq e blegtorë, që çfrytëzonin tokat e kullotat për rreth qytetit, të cilat nuk i pushtuan me forcë por ia u dhanë ilirët në shkëmbim me prodhime t'artizanatit grek apo në bazë të marrëveshjeve të tjera. Ndër zanatlinjt një rol me rëndësi luanin muratorët e gurë-gëdhëndësit si dhe poçarët. Të parëve, që ishin njëkohësisht edhe arqitektë, u takonte të ndërtonin jo vetëm shtëpiat e banimit dhe muret e para mbrojtëse, që i snguronin këto nga sulme eventuale ilire, por edhe godinat me karakter zyrtar, ndër të tjera tempujt e atyre perëndive, që adhuroheshin nga banorët, në ballë të të cilëve qëndronte Apolloni dhe e motra Artemizi, hyjnesha e grigjeve dhe e gjuetisë. Poçarët ishin po aq të domosdoshëm mbasi enët e përdorimit të përditshëm përgatiteshin kryesisht prej balte të pjekur. Me gjithë këtë një tok sende t'artizanatit, veçanërisht enë luksi, duke përfshirë edhe enë prej balte të pjekur, që ishin të pikturuara artistikisht në sipërfaqe vijshin në fillim kryesisht nga Greqia d.m.th. nga vëndi ose më mirë të themi nga qytetet e origjinës së qytetarëve të Apollonisë, kurse në shekujt e mëvonshëm edhe nga viset e botës greke veçanërisht nga kolonitë greke të bregdetit perëndimor t'Adriatikut.

Duke qënë se ilirët për rreth, në këtë kohë, d.m.th. në shek. VI para erës së re dhe disa kohë më tej, jetonin në etapën e komunes primitive, me fjalë të tjera nuk njihnin marrëdhënje të tjera veçse shkëmbimeve në natyrë, kolonistëve t'Apollonisë iu desh në fillim ta zhvillonin tregëtinë e tyre me vëndasit nëpërmjet të kësaj tregëtije primitive. Moneta, që njihej dhe përdorej nga kolonistët, qarkulloi prandaj në fillim vetëm në qytet ose në marrëdhënjet e tyre me botën tjetër helene. Mallrat, që shkëmbeheshin ishin kryesisht sende të përdorimit të përditshëm, në radhë të parë objekte t'artizanatit, që silleshin nga Greqia ose punoheshin n'Apolloni dhe prodhime bujqësore, blegtorale lëndë druri dhe minerale, me të cilat ilirët furnizonin qytetin e Apollonisë dhe nëpërmjet të tij mbulonin edhe nevojat e Korkyrës (Korfuzit) dhe të Korinthit, me banorët e të cilëve qytetarët e Apollonisë kishin lidhje gjaku e gjinije.



Kolonistët, që u ngulën në pika të ndryshme të bregdetit ilir duke përfshirë edhe ato t'Apollonisë, kishin një sistem shoqëror të ndryshëm, shumë më të përparuar nga ay, që njihnin vëndësit ilir, sistemin skllavo-pronar. Në jetën ekonomike të qytetit por edhe të një pjese të madhe të familjeve, luanin një rol me rëndësi skllëvërit. Puna e skllavit shfrytëzohej në zejтари e bujqësi, në lundrim e transport por edhe në punët shtëpikaje. Me skllëvërit zhvillohej një tregëti e gjërë, këto shiteshin edhe bleheshin në treg si edhe prodhimet e tjera e kafshët. Pjesa më e madhe e këtyre skllëvërve, që shfrytëzoheshin nga kolonistët e Apollonisë ishin pa tjetër ilirë nga origjina, kryesisht rob luftime të zënë nga taulantët në luftë me fise të tjera ilire. Trajtimi i tyre ka qënë pothuajse gjithnjë më se çnjerëzor. Ato ishin të detyruar shpesh herë të punonin duke qënë të lidhur me pranga (hekura) në të dy këmbët. Shëmbulli i skllavit të Durrësit, që u shtie në vorr me gjithë pranga (sot janë ekspozuar në muzeun e këtij qyteti) nuk duhet të merret si një ndodhinë e jashtëzakonëshme por që vërteton se sa egër dhe të paspirt silleshin pronarët kundër kësaj klase, që nuk gëzonte as të drejtat më elementare. Për fajin më të vogël skllëvërit mund të vriteshin pa një pa dy nga pronarët e tyre. Në këtë pikë nuk bënin përjashtim as qytetarët e Apollonisë megjithëse qyteti përmëndeje në kohë antike për ligjet e mira që kishte, por këto ligje ishin natyrisht vetëm në dobi të qytetarëve të lirë

Qyteti i Apollonisë kishte një regjim demokratik ku skllëvërit sikurse e pamë më sipër, nuk gëzonin asnjë të drejtë. Në të vërtetë n'administrimin e qytetit nuk merrnin pjesë të gjithë banorët e lirë por vetëm shtresat e pasura, bile në fillim vetëm aristokracia. Më vonë shtresat e tregëtarëve dhe të zejtarëve që u pasuruan shumë nga tregëtia e Apollonisë me krahinat ilire rreth e rrotull, duke forcuar kështu shumë pozitën e tyre, e detyruan pakicën aristokrate t'u njoñi atyre disa të drejta, që nuk i kishin pasë gëzuar më parë, ndër të tjera pjesëmarrjen në çështjet e administrimit të qytetit.

Në krye të qytetit qëndronte një qytetar, që zgjidhesh nga mbledhja e përgjithëshme e popullsisë së lirë krye çdo viti. Ky quhej prytan dhe ishte kryetari i organit më të lartë ekzekutiv të qytetit të përbërë prej një këshilli prej pesë vetësh. Nëpunës të tjerë, që e ndihmonin këtë në vepimtarinë e tij ishin sekretari dhe tre funksionarë të lartë që quheshin hieramnomonë; secili nga këta përgjigjesh për çështje të caktuara qofshin me karakter kulturi (fetar) apo civil. Ne njohim nga mbishkrime të gjetura në Pojan, d.m.tn në toka ku shtrihet dikur Apollonia dhe sidomos nga monetat argjendi e bronxi të prera në këtë qytet me qindra emra prytanësh ose funksionarësh të tjerë të lartë. Me gjithë këtë jemi ende larg të dijme rrjeshtimin kronologjik të këtij brezi të gjatë prytanësh. Organizimi i çfaqjeve teatrale dhe i lojrave gjimnastikore, që zinin një vënd me rëndësi në




jetën kulturele të qytetit dhe që në kohë antike nuk i mungonin asnjë qyteti sa do i vogël që t'ishte, kryhesh prej këtij kolegji, pjesëtarët e të cilit jo vetëm që nuk merrnin rrogë, por ishin detyruar të hiqnin edhe shpenzimet e këtyre lojtrave. Në kompetencën e tyre hynin edhe vendimet dhe ligjet e ndryshme, marrëveshjet dhe aleancat me qytete, fise dhe shtete të huaja, vjelja dhe administrimi i t'ardhurave, prerja e monetave, organizimi i mbrojtjes së qytetit, komandat ushtarake në raste lufte etj.

Për një shekull rrjesht Apollonia varej ekonomikisht dhe politikisht nga qytetet mëma d.n.m.ch, Korkyra e Korinthi prej nga kishin ardhë kolonistët e parë. Nga mezi i shekullit të pestë para erës së re ekonomia e qytetit është mëkëmbur në një shkallë të tillë sa që nuk ndihej nevoja e një mbështetjeje të jashtme. Këtë mbështetje ekonomike qytetarët e Apollonisë e gjetën tashti tek Taulantët e fiset e tjera ilire, me të cilët ato kishin vendosur me kohë marrëdhënie shumë të ngushta tregtare. Zhvillimi në mënyrë miqësore i këtyre marrëdhënjëve, nga të cilat varesh mirëqënia por edhe zhdukja e kolonisë, i lejoi Apollonisë që të kërkojë e të gjejë edhe mbështetje politike tek Taulantët, të cilët nga ana e tyre për hirë të shpeshtimit të marrëdhënjeve kulturele e shoqërore me kolonistët helenë, mundën të largohen shumë nga jetesa primitive, që ishte bërë pengesë serioze për përparimin e tyre shoqëror dhe ja arritën kështu të formojnë shtetin e tyre të fortë në shek. IV para erës së re.

Kjo autonomi përkundrajt qyteteve mëmë u shpreh më me forcë e më qartë kur Apollonia aty nga viti 450 para erës së re ngriti punishtën e vet monetare dhe filloi të presi monetat e para prej argjendi, që mbanin përsipër emrin e shkurtuar të qytetit. Në dukje të jashtme këto moneta argjendi nuk ndryshojnë veçse nga emri i qytetit prej monetave të njëkohëshme të Korkyrës. Në faqe ato paraqesin një lopë, që i jep të pijë vicit kurse shpinën e monetës e zbukuron një katerkëndësh i dyfishtë i mbushur me ornamente të thjeshta. Këto moneta të para të preme në punishtet e Apollonisë quheshin statore dhe kishin një peshë prej afërsisht 11'5 gramësh. Vurja në qarkullim e kësaj monete autonome u bë e nevojshme në radhë të parë për shkak të shtimit të madh të shkëmbimeve tregëtare në mes të qytetit e të krahinave ilire për rreth, popullsia e të cilave kishte filluar në këtë kohë të pranojë si mjet shkëmbimi edhe monetën prej argjendi.

Me krijimin e shtetit Taulant, aty nga fillimi i shek. IV, Apollonia i nënshtrohet influencës politike të këtij shteti. Kjo i lejoi qytetit të shumëfishojë lidhjet ekonomike jo vetëm me Taulantët, por nëpërmjet tyre edhe me fiset më të largëta ilire. Nga ana tjetër ilirëve iu dha tani mundësia jo vetëm të vendosen në qytet por të fitojnë këtu të njëjtat të drejta dhe detyra sikurse qytetarët me origjinë helenë. të kenë pasuri, t'ushtrojnë zanate, bile të marrin pjesë aktive edhe në





Pamje e pjesëshme e gërmimeve të kyera para çlirimit.



qeverisjen e qytetit dhe t'arrijnë të zënë deri shkallët më të larta duke u bërë prytanë. Nga shekulli IV e më poshtë ne gjejmë në udhëheqjen e qytetit një tok ilirë, disa prej të cilëve i njohim pikërisht prej emrave thjesht ilire, që mbajnë: Genth, Preurad, Falakrion.

Ky bashkëpunim kaq i ngushtë në fushën politike e ekonomike me ilirët i dha një hov edhe më të madh zhvillimit të gjithanëshëm ekonomik e kultural të qytetit. Në gjysmën e dytë të shekullit IV para erës së re qyteti i Apollonisë arrin lulëzimin e tij më të madh; kësaj periudhe i përkasin ndërtimi i sheshit monumental të qytetit për të cilin do të flasim më poshtë, muri rrethues i soçëm i ngritur pjesërisht mbi themelet e një muri më të lashtë, i cili kishte për qëllim ta mbronte qytetin nga sulmet eventuale armike si dhe godina të tjera madhështore, gërmadhat e të cilave, sikurse do ta shohim më poshtë, pjesërisht janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike. Shtimi i tregëtisë me fiset e afërme dhe të largëta ilire si dhe me qytetet fqinj, si me Bylisin, (në kat. Hekal të Mallakastrës), Amantien (Ploça e Vlonës), Olympen (po në këtë pellg por me përpikmëri nuk ia dijmë ende vëndin) i lejoi Apollonisë që të presë një monetë të re me të njejtat figura por që kishte vetëm një të tretën e peshës pra edhe të vleftës të staterit. Kjo monetë e re argjendi, drahma e përmëndur ilire, pushtoi më vonë së bashku me drahmën e qytetit vlla Dyrhionit (Durrësit) jo vetëm tregun e fiseve ilire të Ballkanit por hyni në radhën e monetave internacionale të kohës dhe e shtrini influencën e sajë ekonomike deri thellë në tokat e Thraakisë e Dakisë d.m.th. në teritoret, që përfshihen sot nga R.P. të Bullgarisë, Rumanisë dhe Ungarisë. Jo vetëm kaq, drahma ilire e të dy qyteteve më të mëdhenj dhe ekonomikisht më të fuqishëm të pellgut t'Adriatikut, d.m.th. Apollonisë e Dyrhionit u bë model për një monetë argjendi të Romës, për viktoriaatin. Roma përgatitej aty nga mezi i shek. III-të para erës së re të shtrinte sundimin e vet mbi brigjet lindore t'Adriatikut, n'Iliri, por një ndërmarrje e tillë nuk ishte e lehtë dhe nuk mund të jepte rezultate të kënaqëshme po qe se më parë nuk do të fillohej me penetrimin ekonomik t'Ilirisë. Duhej pra mbi të gjitha të thyhej fuqija ekonomike dhe stima e mirë, që gëzonin drahmet e Apollonisë dhe të Dyrhionit në tregun ilir dhe kjo detyrë iu besua viktoriaatit, të cilit iu dha jo vetëm pesha por edhe forma e jashtme e drahmës. Konkurenca ndërmjet drahmave ilire t'Apollonisë e të Dyrhionit dhe viktoriaatit romak në tregun ilir dhe dak 1) vazhdoi deri aty nga viti 100 para erës së re; vetëm hjedhja në treg e denarit që ishte një të tretën më i rëndë në peshë se sa drahma ilire dhe sidomos pushtimi ushtarak i pjesës më të madhe të Ballkanit nga Roma, e detyroi edhe punishten monetare t'Apollonisë të heqi dorë nga prerja e drahmave.

1) Populli Dak banonte kryesisht në krahinat lindore t'Ungarisë dhe në Rumani.



Gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së saj, veçanërisht në shekujt e parë mbas themelimit të qytetit, Apollonisë iu desh të përballojë shumë sulme të jashtëme, në rradhë të parë të fiseve ilire. Këta përleshje, të cilat shpesh herë e vinin në rrezik zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e kultural të qytetit, e kishin burimin në shkaqe të ndryshme. Një ndër këto shkaqe ishte dëshira e qytetarëve të Apollonisë të shtynin kufinjtë tokësorë të qytetit dhe t'i grabitnin ilirëve për rreth toka të tjera, gjë kjo që ndeshte në kundërshtimin e armatosur të banorëve vëndas. Një luftë e tillë ndodhi nga mezi i shek. V para erës së re kundër qytetit ilir Thronion, të banuar nga fisi i Amantëve. Apollonasi dolën fitues dhe në shenjë mirënjohjeje për ndihmën që i dhanë perënditë — sikurse dihet të vjetrit ishin politeistë d.m.th. adhuronin jo një por një tok perëndi — me një të dhjetën e plaçkës së zënë në luftë ndërtuan një monument të madh skulptural që e ngritën jo n'Apolloni, por në vëndin më të shënjtë të botës greke, n'Olympia.

Në më të shumtën e herës shkak lufte u bë edhe pasuria e madhe e grumbulluar nga qytetarët e Apollonisë në sajë të tregëtisë së favorëshme, që bënin me ilirët ose me botën tjetër antike. Në vitin 314 para erës së re Apollonia mësyhet dhe pushtohet nga mbreti Kasandër i Maqedonisë, qëllimi kryesor i të cilit ishte jo vetëm t'i zgjerojë kufinjtë e shtetit të tij deri në Adriatik por të mbushi edhe thesarin mbretëror, që kishte shkuar në fund nga luftrat e Aleksandrit të madh n'Azii si dhe nga luftrat për fron që plasën mbas vdekjes së tij. Por pushtimi maqedon nuk zgjati shumë. Me ndihmën e Taulantëve t'udhëhequr nga mbreti i tyre Glaukia, qyteti u çlirua prap në vitin 312 para erës së re. Pirroja, mbreti i shtetit të fortë t'Epirit, duke përfituar nga vdekja e Glaukisë dhe nga grindjet për fron që plasën ndërmjet djemve të tij, e shtrini sundimin e vet edhe mbi Apolloninë, të cilën e përdori si bazë për ndërmarrjet e tij luftarake kundër Romës, e cila i kërcënonte lirinë Tarentit dhe qyteteve të tjera helene të bregdetit lindur të sinisisë italice. Tregohet për këtë mbret të guximshëm, të regjur e të kalitur në dhjetra luftra, se kishte kërkuar të projektonte hjedhjen e një ure nga bregdeti i Apollonisë për në brigjet e përtejme italice. Pirros nuk i shkante natyrisht përmend me hedhë me të vërtetë urë mbi Adriatikon. Shprehja, në qoftë se është me të vërtetë e tij, ka për qëllim me vue në dukje guximin e jashtëzakonshëm që shquante trimin e maleve t'ashpra të Epirit në të gjitha ndërmarrjet e tij luftarake dhe mos përkuljen e tij përkundrojt vështirësive e pengesave sado të mëdha e të pakapëryeshme që t'i paraqiteshin.

Mbas vdekjes së Pirros Apollonia vazhdon të jetë për një kohë mollë e grindjes ndërmjet Aleksandrit dytë, pasardhësit të Pirros në fronin e Epirit dhe Mytilit njerit prej djemve të Glaukisë. Mytili



në përpjekjen e tij për të çliruar Apolloninë dhe tokat e tjera të rrëmbyera dikur nga Pirroja, nuk ia arrijti qëllimit. Apollonia i drejtohet aty nga viti 270 për ndihmë Romës por kjo, tue pasë ende në kujtim goditjet e rënda, që pësoi nga Pirroja para pak vitesh, nuk guxoi t'i mësyjë luajt e Epirit në strofkën e tyre dhe i dëboi nga Roma delegatët e Apollonisë. Me gjithë këtë qyteti mundi me ndihmën e Maqedonisë të shkëputej aty nga viti 268 para erës së re nga mvartësia e Epirit dhe të lidhet rishtas ekonomikisht e politikisht me shtetin e Taulantëve.

Por kjo lidhje u shkëput me daljen në skenë dhe me vërshimin drejt jugut të fisit ilir të Adrianëve, Shteti taulant me të cilin Apollonia që lidhur shekuj me rradhë nuk është më. As Agroni as e shoqja dhe pasardhësja e tij Teuta nuk përpiqen të vendosin marrëdhënie fqinjësie të mirë me Apolloninë, por kërkojnë t'ia nënshtrorjnë qytetin sundimit të tyre dhe e rrethojnë këtë nga deti e nga toka. Për të shpëtuar nga kjo gjëndje e vështirë që kërcënon seriozisht zhvillimin e mëtejshëm ekonomik por edhe lirinë e qytetit, Apollonia i drejtohet rishtas për ndihmë Romës, e cila me pushtimin e Tarentit në bregun e përtejme t'adriatikut ishte bërë fqinjë për det me të. Këtë herë ndihma nuk vonohet. Thirrja e Apollonisë i erdhi për mbarrë Romës. që i kishte drejtuar prej kohe sytë nga brigjet ilire. Flota dhe ushtritë ilire u detyruan të heqin dorë nga rrethimi i Apollonisë. Qyteti hyri në sistemin e aleancës romake, që e detyronte Apolloninë t'i jepte Romës ndihma ushtarake në raste lufte por i linte qytetarëve dorë të lirë në rregullimin e çështjeve të mbrëndëshme, në vazhdimin e prerjes së monetave autonome dhe sidomos në zhvillimin e tregëtisë me fiset ilire, që shtriheshin për rreth Apollonisë dhe që ishin shkëputur tash nga mvartësia e Ardianëve. Kjo ndodhi në vitin 229 para erës së re.

Ngjarjet e vitit 229 nuk mund t'i pëlqenin Maqedonisë, e cila në aleancën që lidhi Roma me Apolloninë, Dyrhjonin dhe disa fise ilire t'Ilirisë së jugut, shihte me të drejtë një rrezik serioz për sigurinë e saj. Mbreti Filipi V-të i Maqedonisë hyri përndaj në marrëveshje me Anibalin armikun më të betuar të Romës, që të mos e lerë këtë të bëhet zot i Apollonisë e pikave të tjera strategjike t'Ilirisë. Në vjetin 200 para erës së re zbrësin n'Apolloni ushtëri të shumta romake, që nisen së këtejmi kundër kufinjve të Maqedonisë. Prej kësaj date e deri në vjetin 168 para erës së re, vit në të cilin munden dhe shpartallohen nga romakët tre nga shtetet më të fuqishëm të Ballkanit, Maqedonia e mbretit Perse, shteti ilir i udhëhequr nga Genci dhe shteti i Lidhjes së Epirotëve, Apollonia është vazhdimisht bazë e fuqishme ushtarake romake. Jo vetëm kaq; në ushtrinë romake, që nisesh kundër Gencit, detyrohen të marrin pjesë edhe reparte ndihmëse të formuar nga qytetarë të Apollonisë. Romakët e shpërblejnë Apollo-



ninë për këtë ndihmë ushtarake duke i dhënë një pjesë të anijeve, që i plaçkisnin ilirëve.

Dobësimi i pushtetit të Teutës dhe 60 vjet më vonë asgjësimi i shteteve maqedone, ilire dhe epirote nga ana e romakëve, i çoll rrugën Apollonisë për të zgjeruar tregëtinë e vet deri me viset më të largëta të Ballkanit dhe të grumbullojë një pasuri të madhe, e cila pasqyrohet edhe në zhvillimin kulturor e artistik, në rritjen e madhe të popullsisë dhe për pasojë edhe të vetë qytetit. Arti, veçanërisht ai i skulpturës, ngre tashti n'Apolloni një shkollë më vetëhe, që nuk kopjon më me besnikëri veprat e mjeshtërive më të dëgjuar të botës greke, siç bënte më parë, por ndjek shpesh herë një rrugë të vetën dhe krijon disa vepra origjinale. Bien në sy për originalitetin e kompozimit të tyre, për harmoninë e ndërtimit dhe për pasurinë, zgjedhjen e rrjeshtimit e zbukurimeve mbi të gjithë gurët e varreve, që i ngrej në në këtë periudhë shtresat e pasura të popullsisë të vdekurve të tyre. Këto monumente vorresh nuk i hasim në këtë bukuri n'asnjë vend tjetër të botës antike.

Në këtë kohë veprojnë në qytetin e Apollonisë edhe një tok shko-lla të tjera për filozofi, oratori, etj. që gëzojnë një stimë të mirë bile deri në rrethet më të larta të shoqërisë romake. Në qytetin tonë ndodhej për studime kur iu vra i ungji, Jul Cesari i përmëndur, nipi i tij Oktavian Augusti, i cili më vonë u bë perandori i parë i Romës. Bashkë me këtë studjonte në Apolloni një nga ushtarakët më të zot të Romës, Agripa, fituesi i betejës së Aktiumit, (në gjirin e Prevezës) që ishte vendimtare për vendosjen e regjimit perandorak në Romë. Oratori i përmëndur romak, Ciceroni, që e viziton qytetin e Apollonisë nga mezi i shekullit të parë para erës së re, me gjithë që vjen nga një qytet i madh, si Roma e cila ishte kryeqyteti i perandorisë më të madhe të kohës, mbeti i habitur kur shkeli në bregdetin ilir dhe para syve të tij iu çfaq panorama madhështore e Apollonisë. Në shkrimet e tij Ciceroni është plot lëvdata për këtë qytet ilir dhe e quan «Magna urbs et gravis» dm.th. qytet i madh dhe hijerëndë. Popullsia e Apollonisë mund të çmohet në këtë kohë, duke u nisur nga hapësira që zinte qyteti, në rreth 60.000 banorë, për atë kohë me të vërtetë një popullsi e madhe.

Gjatë luftës civile romake, që zhvillohet ndërmjet Pompeut dhe Cezarit për pushtet, Apollonisë i takon të bëhet qendër ushtarake e këtij të fundit kurse në Durrës e ngre shtabin e vet kundërshtari i tij. Fitimi i betejës vendimtare nga Cezari dhe marrja më vonë e pushtetit nga nipi i tij Oktavian Augusti, e vuri Apolloninë në një pozitë më të favorëshme se sa Durrësin. Ndërsa Durrësi shndërrohet në koloni romake, Apollonia ngrihet prej Augustit, që dëshironte ti shprehte mirënjohjen e tij për kohën që kishte studjuar këtu si dhe për naty-  
mën, që i dha Cezarit në luftën kundër Pompeut, në shkallën e një



qyteti të lirë e të paprekshëm. Ky privilegj i dha mundësi Apollonisë ta ruaj deri diku, natyrisht mbrënda kuadrit të perandorisë romake, pavarësinë e saj ekonomike e kulturele. Qyteti vazhdon edhe mbas këndeve të presi për një kohë moneta argjendi që mbajnë emrin e qytetit. Por në përshtatje me rrethanat e reja politike rolet këmbehen. Ndërsa në shekullin e tretë ishin romakët ato që e muarën për shëmbull dramën ilire, moneta e re e Apollonisë i përgjigjet tani në peshë krejtësisht denarit romak; rrezeja e veprimit të monetës së re, që nuk ka në faqe lopën me vëç, por kryet e perëndisë Apollon, i cili i kishte dhënë emrin e qytetit, nuk shtrihet shumë më përtej se në qarkun e ngushtë të qytetit. Shpinën e këtyre monetave e zbukurojnë tri nimfe, tre të bukura dheu, kulti i të cilave ishte shumë i përhapur në qytet.

Gjatë sundimit të perandorëve të parë Apollonia vazhdoi të presë edhe moneta prej bronxi të cilat në faqe mbajnë kryet e perandorit sundues dhe në shpinë emrin si dhe stemën e qytetit ose të ndonjë godine apo skulpture të përmëndun t'eksponueme diku në qytet. Liri disi të plotë gëzonin qytetarët e Apollonisë edhe në rregullimin e çështjeve të mbrëndëshme të qytetit. Gjuha zyrtare mbetet gjithnjë greqishtja me gjithëqë në jetën ekonomike e administrative të qytetit, përveç helenëve dhe ilirëve, marrin pjesë edhe një numur i madh personash me origjinë romake. Këtë e kanë vërtetue edhe zbulimet arkeologjike në Pojan, ku të gjithë dokumentat e shkrueme mbi gur apo pllaka bakëri, qofshin këto me karakter zyrtar si dekrete e vendime apo me karakter privat, si gur varri, mbishkrime përkujtimore etj. deri në perëndimin e sundimit romak ose të thomi ma drejtë deri në prishjen e qytetit, janë hartuar pa përjashtim në gjuhë të vjetër greke.

Me gjithë trajtimin e privilegjuar, të cilin nuk ia kufizojnë Apollonisë as perandorët e tjerë, që vijnë mbas Augustit, qyteti fillon e humb dalë nga dalë por në mënyrë të pashmangëshme madhështinë e dikurshme. Zhvillimi ekonomik e kultural i qytetit fillon e merr t'atjetën jo vetëm për faj të kontradiktave gjithnjë më t'ashpra që plakos aty nga shekulli i tretë i erës së re shoqërinë skllavo-pronare, por edhe për arsye se limani i Apollonisë, që lidhet me detin nëpërmjet të Vjosës, nuk është në gjëndje ti bëjë konkurrencë Durrësit dhe as që është në gjëndje të ndalojë mëkëmbjen e një limani të ri më në jugë, limanin Aulon, Vlorën e soçme. Por grushtin e vdekjes ia sjell qytetit t'Apollonisë Vjosa, e cila aty nga fundi i shek. II apo fillimi i shek. III t'erës së re, çan një shtrat të ri disa kilometra më në jugë. Kjo ngjarje shkaktonte që Apollonia të humbi bazën e saj kryesore ekonomike dhe nga një qytet, si me thanë bregdetar, të katandiset në një qytet toksor të rrethuar pjesërisht me moçale. Pjesa e popullsisë, që e siguronte jetesën nëpërmjet detit, filloi të shpërngulet në Aulon (Vlo-



në) e limane të tjera, një pjesë tjetër zgjodhi jetën fshatare dhe u tërhoq në fshatrat për rreth si bujq të lirë apo si bujk-robër pranë pronarëve tokash. Tërmeti i madh i vitit 345 më në fund që shkatërrojë në themele shumë qytete antike të vendit ndër të tjerë në mënyrë tepër të rëndë edhe Durrësin, detyroi të tërhiqen nga gërmadhat e shkaktuara nga tërmeti edhe atë grusht të fundit të popullisë, që kishte ngurrue të largohet nga vatrat shekullore. Mbas një jete dhe një historije të shkëlqyer më se 900 vjeçare, qyteti i Apollonit, ashtu si dhe vetë perëndia që ia lëshoi vëndin martirëve dhe shenjtorëve të krishterimit, nuk asht më. Kujtimin e tij na e ruen në formë mjaft të deformuar katundi i soçëm Pojan si dhe manastiri dhe kisha e Shëmrisë s'Apollonisë, të cilat ngrihen pikërisht në vëndin ku dikur vetëtinin prej rezeve të Diellit fasada madhështore dhe shtyllat eiegante të një tempulli kryelart pagan.


Apollonisë i ndihet zëri edhe në fillimin e periudhës bizantine; jo më si qytet por si peshkopatë.

\* \* \*

Të shohim tashti se ç'na kanë dhënë kërkimet e gërmimet e deritashme arkeologjike të Pojanit në tokat e të cilit shtrihej Apollonia qyteti më i madh antik i Adriatikut, kjo qendër kulture e dorës së parë dhe qendra ekonomike më e rëndësishme e bregdetit ilir mbas Dyrhionit. Gërmadhat e Apollonisë kanë pas tërhequr vazhdimisht vëmëndjen e shtegtarëve të huaj që vizituan vëndin tonë në shek. XIX. Këto shtegtarë janë të parët që na japin në librat e tyre ndonjë shënim mbi atë apo këtë skulpturë ose mbishkrim sot të çdukur. Aty nga viti 1861 vjen në Pojan arkeologu francez Hezej, që asht i ngarkuar nga Napoloni III i Francës për të studjuar në vend luftën civile romake që u zhvillua në mes Cezarit e Pompeut. Hezej na përshkruan një tok monumente arkeologjike si pjesë arqitektonike, skulptura, mbishkrime etj. shumica e të cilave nuk janë më sot. Disa nga këto skulptura, shkencëtari francez i muar me vetëhe dhe ndodhen sot në muzeun e Luvrit në Paris. Sasia numerike e monumentave arkeologjike që përshkruhen e përfytyrohen në vjetin 1900 në librin e botuar nga historiani Paç si të ndodhuna në Pojan është shumë më e madhe, por edhe nga këto vepra, ndër të cilat disa me vlerë të madhe artistike, vetëm një pakicë e vogël mundi ti shpëtonte rrebeshit të kohës dhe pakujdesisë së regjimit tyrk. Gjatë luftës së parë botnore erdhën në Pojan dy arkeologë austriakë, të cilët kishin ardhur të bëjnë studime arkeologjike n'atë pjesë të Shqipërisë që ishte pushtuar nga ushtria Austro-Ungareze. Duke kuptuar rëndësinë e madhe që paraqiste Apollonia nga pikëpamja arkeologjike, ato i përqëndruan kërkimet e tyre kryesisht në Pojan, ku zhvilluan edhe disa gërmime të kufizuara. Au-



striakët mblodhën në Pojan dhe rrethet e afërme të gjitha skulpturat më të rëndësishme përsa i përket vlefës së tyre artistike, dhe deshën ti transportonin këto për në Durrës dhe s'andejmi për në Vjenë. Ato hasën në kundërshtimin e vendosur të tre oficerave shqiptar, që shërbenin asokohe në radhët e ushtrisë austro-hungareze. Kjo vendosmëri i pengoi për një kohë austriakët ta vënë në jetë këtë grabitje, por patriotët shqiptar e paguan këtë kundërshtim me kokën e tyre; kundër tyre u kurdën një akuzë për tradhëti të lartë, se gjoja kishin lidhje me ushtrinë italiane, me të cilën austriakët ishin në luftë gjatë luftës së parë botërore. Gjyqi ushtarak i dënoi me vdekje. Skulpturat dhe objektet e tjera arkeologjike, që u çuan në Durrës me qëllim që ti transportonin me anën e detit për në Austri, ishin me qindra. Për arsye se rruga e detit ishte e rrezikuar nga nëndetset dhe flota armike, vetëm një pjesë e vogël e këtyre skulpturave mundi t'arrijë në muzeun e Vjenës, ku ndodhet edhe sot. Nga objektet që mbeten në Durrës një pjesë ruhet në Muzeun Arkeologjik dhe Etnografik të Tiranës, kurse një pjesë tjetër u çduk; thuhet për to se i muarën italianët kur hynë në Durrës (1918) mbas tërheqjes së Austriakëve, por ka të dhëna që mund të jenë mbuluar nën rrënojat e shtëpisë, ku ato u vendosën kur u suallën nga Pojani; se cila ishte kjo shtëpi nuk është mundur ende të diktohet.



Muri që rrethonte kodrën mbi të cilën ngrihej një tempull.



Por vepra artistike të zbuluara n'Apolloni nuk ka vetëm në Vjenë. Nji tok monumente të tjera antike rrëmbyen edhe muzet e Stambollit, të Parisit e të vëndeve të tjera. Dëmin më të madh e të pariparuarshëm e pësuan monumentat kulturore t'Apollonisë jo nëpërmjet të këtyre grabitjeve, por nga regjimi i paaftë turk dhe nga padija në të cilën e zhyti ky regjim popullin tonë. Nga fundi i shek. XVIII nji nga pashallarët e Beratit (Ibrahim Pasha) tërhoqi nga gjermadhat e Apollonisë, nga nji monument vorri në formë tempulli, më se shtatdhjetë qerre me gur të skalitur, të cilët i përdori për të ngritur sarajet e veta si dhe godina të tjera. Teqja e bukur e Xhelvetive në Berat ashtu ndërtoar pikërisht me material gurësh, që u muarën nga tempulli i përmëndun. Në disa raste grabitja ka qënë aq e rëndë sa që nga një faltore tjetër, tempulli i Shtyllasit mbi nji kodër në jugë të Apollonisë, ka mbetur në këmbë vetëm një shtyllë e vetme, për të cilën populli thotë se në të lidheshin gjemitë (anijet). Në të vërtetë kjo shtyllë e vetmuar është nji ndër dhjetra kollonat, që rrethonin faltoren pagane. Ende në vitin 1900 vepronin n'Apolloni nji tok furra gëlqeresh, që ushqeheshin e digjshin skulptura e mbishkrime antike të skalitura mbi gur gëlqerorë ose mermer. Kuptohet vetiu se dëmi i shkaktuar nga të tillë furra ka qënë i madh dhe ka shkaktuar çdukjen e plotë të shumë vlerave artistike dhe historike. Pjesa më e madhe e monumentave antike, që njohim para kësaj date nëpërmjet botimeve nëpër libra të hueja, u zhdukën e u bënë gëlqere.

Nji shkak i tretë për zhdukjen e shumë monumenteve të kulturore materiale të Apollonisë ishte pozita gjeografike e qytetit, i cili u ngrit në nji krahinë të varfër në materiale ndërtimi. E gjithë Myzeqeja e përdori Apolloninë për shekuj me rradhë si gurore. Jo vetëm pjesa dërmuese e shtëpijave private të kësaj krahine të gjërë e ka tërhequr materialin e gurtë nga Apollonia, por edhe xnamitë dhe veçanërisht kishat, janë ngritur pjesërisht apo tërësisht me materiale ndërtimi të sjellur nga gjermadhat e këtij qyteti antik. Shumë nga këto kisha mbajnë në muret e tyre edhe sot e kësaj dite skulptura, mbishkrime, kokë shtyllash e pjesë të tjera arqitektonike të marruna n'Apolloni. Kjo grabitje e vazhdueshme ka shkaktuar, që mbrënda territorit të qytetit antik të mos ketë mbi tokë as edhe nji mbeturinë të vetme muri ndërtese. Nga grabitja shpëtuan vetëm ato gjermadha, që u mbuluan në vazhdim të kohës nga rrëketë e shkaktuara nga shirat, nga shëmbjet e lëvizjet e ndryshme të tokës etj.

Në këtë gjëndje ishin gjermadhat e Apollonisë nga mezi i shek. XIX. kur Napoloni i tretë dërgoi në brigjet shqiptare e n'Apolloni arkeologun Hezej por edhe në vitin 1916-7 kur për herë të parë arkeologu austriak Prashniker nguli kazmën këtu për të bërë kërkimet e para arkeologjike në nëntokën e qytetit më të rëndësishëm arkeologjik të vendit tonë. Duke u nisur nga përfundimet plot sukses të kë-





Pamje tjetër e gërmimeve: Në plan të parë biblioteka, në të djathtë teatri i vogël në sfond portiku.



24802

BIBLIOTEKË

32033

tyre gërmimeve të para arkeologjike të kryera në Apolloni nga austriakët qeveria franceze kërkoj në vjetin 1922 prej qeverisë s'atë herëshme shqiptare një koncesion arkeologjik mbi një pjesë të tokës shqiptare; në këtë koncesion, të parapamë për një kohë të gjatë prej tridhjet vjetësh, përfshihej edhe Apollonia. Me gjithëse aso kohe në Shqipëri nuk kishte asnjë arkeolog vëndas pra nuk kishte as mundësi që gërmimet arkeologjike të mund t'i nënshtroheshin një kontrolli të imët shtetnor, shoqëria franceze, e njohur më tepër nën emrin misioni arkeologjik francez, arriti ta marri këtë koncesion. Marrëveshja parashifte që të gjitha sendet, që do të zbuloheshin gjatë gërmimeve, do ti dorëzoheshin qeverisë shqiptare; në rasë se do të dilshin dy objekte krejt të njëllajta, gjë që ndodh shumë rrallë dhe në sende jo fort të vlefshme, atëhere një i takonte shoqërisë franceze. Të gjitha shpenzimet e gërmimeve shkojshin në kurriz të misionit arkeologjik francez, i cili ruante për vetëhe të drejtën për t'i botuar përfundimet në një revistë të posaçme në gjuhë frënge me emrin «Albania», nga e cila duellën gjithsejt gjashtë numura.

Misioni arkeologjik francez i filloi gërmimet në Apolloni në vjetin 1924 dhe u detyrua ti ndërpresë në vitin 1939, kur Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste. Për çdo vit kryhej një fushatë gërmimesh, kështu që francezët punuan në Apolloni për 15 vjet rrjeshtë. Për më tepër se 10 vjet objektet e zbuluara mbetën të mbyllura në arka dhe u ndrynë në një dhomë të vogël të Bashkisë së Fierit, për arsye se muzeu që ishte parapa të ndërtohej në këtë qytet nuk mundi të ngrihet përtej themeleve të tij mbasi fondet e nevojëshme mungonin gjithnjë për institucione kulturele. Në vjetin 1936 më në fund qeveria e Zogut, që nuk tregonte as interesim më të vogël, për mbledhjen e studimin e kulturës së lashtë materiale të popullit tonë, vendosi të përshtaste si muze një godinë të vogël në Sqelen e Vlonës, në të cilën në vjetin 1912 Ismail Qemali kishte ngritë flamurin e independencës. Sikurse dihet jeta e këtij muzeu, ku ishin ekspozuar objektet e lëvizëshme, të zbuluara për 15 vjet rrjeshtë n'Apolloni, nuk qe e gjatë. Trimëria e parë që kryen këmishzezët e Musolinit më 7 Prill 1939 me të zbritur në Vlonë ishte grabitja e muzeut. I shpëtuan plaçkitjes vetëm shtatnat e mermerta, mbishkrimet dhe skulptura të tjera, që nuk hynin në trasjet. Koleksioni i bukur i vazove të tipit korinthik, që i përkisnin kohës së themelimit të qytetit d.mth. shek. VI para erës së re, me mijra objekte bronxi, qelqi, balte të pjekur dhe moneta argjëndi e bronxi muerën rrugën për Itali. Fashistët nuk u mjaftuan me kaq; ato organizuan t'ashtuquajturën «Mostra e Përtejdetit» ku përkrah kolonive të vjetra italjane do të përfaqësohej edhe kolonia



20742

e re Shqipëria. Për tu ekspozuar gjoja në këtë pavion u caktuan monumentet arkeologjike më të bukura e më të rëndësishme t'atdheut t'onë ndër të cilat edhe shtati i mermertë i një rromaku të panjohur të mbuluar në Apolloni. Me gjithse në bazë të traktatit të paqës, të lidhur ndërmjet Shqipërisë e Italisë, kjo e fundit ka marrë përsipër të na i dorëzonte sendet e grabitura, qeveria e soçme italjane pretendon se pjesa ma e randësishme e tyre, duke përfshirë dhe shtatnat qënka zhdukur pa lënë gjurmë dhe se prandaj nuk ishte në gjendje ti kthej për derisa nuk do të hetohej se ku ndodheshin

Në fund të vitit 1941 u kryen në Apolloni gërmime arkeologjike edhe nga ana e okupatorëve fashistë. Por këto ishin gërmimet e fundit që bëheshin në Apolloni dhe përgjithësisht në vendin tonë nga të huajt. Mbas çlirimit të Shqipërisë të gjitha marrëveshjet e lidhura me shtetet e hueja që nuk merrnin parasyshë ose që damtonin interesat e popullit tonë, duke përfshirë natyrisht edhe koncesionet arkeologjike, nuk u njohën më nga qeveria e Rep. Pop. të Shqipërisë; E drejta e gërmimeve arkeologjike i kaloi Instiutit të Shkencave, i cili qysh nga vjeti 1948 organizoi në Apolloni gërmimet e para të drejtuara për herë të parë nga arkeologë shqiptarë. Në vitet e para punimet në Apolloni u përqëndruan në pastrimin, rindërtimin dhe në përfundimin e gërmimeve të monumenteve të zbuluara nga të huajt. Gjatë okupacionit italian dhe veçanërisht në vitet e luftës së dytë botërore monumentet arkeologjike t'Apollonisë pësuan dëme të mëdha. Nazistët gjermanë kishin vendosë në Apolloni një bateri detare dhe i kishin bërë strehimet e tyre antiajrore, me qëllim që të mos diktoheshin lehtë nga armiku, në mes të monumentave arkeologjike. Në mënyrë vandale ato shkallmuan mure e godina antike, thyenë për të shtruar rrugët shtylla e pjesë të tjera arqitektonike, me gjithëse rreth e rrotull kishte grumbuj të mëdhenj gurësh të pavlefshëm, që mund të përdreshin fare mirë për këtë qëllim.

### Monumentet arkeologjike

Shënimet kryesisht historike që dhamë sipër mbi Apolloninë mbështeten në përgjithësi mbi të dhënat burimore të shkrimtarëve të ndryshëm helenë dhe latinë, por këto burime antike kanë arritur tek ne shumë të gjymtuara e të varfëra dhe nuk lejojnë të formojmë një ide shumë të qartë, sidomos mbi zhvillimin ekonomik e kultural të qytetit në kohëra të ndryshme. Këtë zbrazi të ndjeshme është në gjendje ta plotësojë deri diku vetëm kultura materiale

d.m.th. objektet e ndryshme si godina, vegla pune, enët prej balte të pjekur apo metali, monetat, skulpturat, zbukurimet trupore, armët, orenditë e ndryshme etj. sende, të cilat sot i mbulon një cipë e hollë apo e trashë dheu. Zbulimi dhe studimi i kësaj kulture materiale është detyra kryesore e shkencës së arkeologjisë Qëllimi i gërmimeve arkeologjike, që janë zhvilluar dhe do të vazhdojnë të zhvillohen për disa dhjetra vjet me radhë në qytetin e Apollonit, nuk është pra kurrësesi të grumbullojë materiale për të mbushur sallat e ekspozitës së muzeut, por studimi i imët shkencor i kësaj kulture për të fituar një pasqyrë sa më të plotë mbi jetën e gjithanëshme të popullsisë së kësaj qendre më të rëndësishme kulturele të vendit tonë.

Në Apolloni ne dallojmë tre kultura kryesore, që vijnë njëra pas tjetrës, por edhe gërshetohen e shkrihen shpesh me njëra tjetrën. Kultura më e lashtë që kemi gjetur në gërmime është kultura materiale ilire d.m.th e popullsisë vëndase, që banonte këtu para se të vijnë kolonistët helenë e të themelonin qytetin e Apollonisë. Por kjo kulturë tue u gjet përballë një tjetre shumë të epërme siç ishte kultura helene, nuk mujti të qëndrojë për shumë kohë dhe iu desh t'ia lëshojë fushën kulturës materiale helene. Ilirët e qytetit, shumë nga nevojat e tyre, veçanërisht në prodhimet zejtarije, si p.sh. në enë baltë, filluan tashti të mbulonin me të tilla helene, që ishin shumë më të bukura, të punuara më çark—ilirët i pregatitin enët me dorë — por edhe shumë më të forta, të brumosura me baltë të zgjedhur e të shtur, dhe, mbi të gjitha të pjekura mirë.

Nga ana tjetër në zakonet vesh-mëbathje si dhe në përdorimin e emrave të trashëguara nga të parët e tyre, ilirët i mbetën besnikë për një kohë shumë të gjatë traditave të vjetra të popullit të tyre.

Por edhe qytetarët helenë t'Apollonisë marrin disa gjëra nga ilirët ndër të tjera zakonet e varrosjes në tuma dhe fusin në kultin fetar të tyre hyjneshën ilire të grigjeve dhe të gjuetisë, të cilën e unjisan me Artimizin grek, që kishte afërsisht të njëjtat funksione. Adhurimi i Apollonit, nën mbrojtjen e të cilit ishte vërejtur qyteti, kalon tash në plan të dytë. Ndër skulpturat e përmendoret, që ngrinin qytetarët për ti nderuar perënditë e tyre të shumtë, vëndin e parë e zinte pikërisht hyjnesha ilire.

Kulturat kryesore, që u zhvilluan në Apolloni dhe e vune atë në radhët e qyteteve më të përmendura të kohës antike ishin: kultura materiale helene, një nga kulturat më të larta që ka njohur bota e vjetër dhe kultura materiale romake, e cila në përgjithësi ndjek traditat e së parës por i jep kulturës botërore, sidomos në teknikën e ndërtimeve, edhe disa elemente të reja. Këto dy kultura i hasim



n'Apolloni pothuajse në çdo çap, që bajmë. Të gjitha ndërtimet me gur të mëdhenj, të skalitur me mjeshtëri e të puthitur njëri mbi tjetrin në teknikë të thatë d.m th. pa përdorur asnjë mjet ndërlidhës si baltë e llaç gëlqereje, i përkasin pothuajse pa përjashtim kohës para-romake; godinat e ndërtuara me gur apo me tulla të lidhura me llaç gëlqereje nga ana tjetër janë të periudhës romake. Ilirët e Apollonisë, për arsye se kultura e tyre nuk njihte veçse ndërtime fund e krye të drunjtja, i përshtaten në përgjithësi arqitekturave më të përparuara helene e romake dhe nuk na kanë lënë prandaj gjurma të një veprimtarie arqitektonike të veçantë.

Një gjë tjetër, që duhet të kihet parasyshë është fakti se godinat e vjetra d.m th. të periudhës para-romake janë shumë më të rralla se sa ato të ndërtuara gjatë pushtimit romak. Kjo është e natyrëshme dhe shpjegohet me zhvillimin e pandërprerë t'Apollonisë, kështu që godinat e vjetra, shpesh herë të dëmtuara rëndë nga vjetërsija apo nga një tërmet, u zavëndësuan vazhdimisht nga të reja, që i përgjigjeshin në teknikë e stil kohës së ngritjes së tyre. Për arsye se qyteti nuk është më në këmbë në kohën bizantine nuk ka natyrisht si të përfaqësohet ndër gjëmatat e Apollonisë as stili karakteristik i kësaj periudhe

Ndër monumentat arkeologjike më të rëndësishme të zbuluar në Apolloni nga shoqëria franceze vendin e parë e zë portiku, sheshi kryesor i qytetit; ky shesh luante një rol të dorës së parë në marrëdhëniet kulturale dhe ekonomike të qytetit. Portiku shërbente jo vetëm si pazar, për shit-blerje, por edhe për takime e bisedime të ndryshme; ashtu edhe si shëtitore, mbasi prej këndeje kishte një pamje të bukur mbi fushat e bregoret, që shtriheshin në perëndim e në jugë të qytetit, mbi bregdetin e Adriatikut të kaltërt, mbi Sazanin e deri në malet e Karaburunit, të Llogarasë, Çikës dhe Kudhësit. Sfondin arqitektonik kryesor të portikut e formonte një rrjesht i gjatë prej 17 kamaresh të gurta të mbështetura në rrëzën e një kodrine, që mban te në majë një nga tempujt më të vjetër dhe më të adhuruar të Apollonisë, tempullin e perëndeshës Artemis. Pak metra përpara këtyre kamareve gjysëm cilindrike, që mbarojnë sipër në kube dhe, që kanë prandaj një përgjashmëri të madhe forme me mimberet e xhamive shtriheshin dy rrjeshta shtyllash paralele, që mbanin përsipër një çati. Shtyllat e rrjeshtit të parë kishin formë tetkëndëshe, stil ky jo i zakonshëm n'artin e arqitekturës helene. Arqitekti i portikut t'Apollonisë i jep edhe kapiteteleve (kokave) të shtyllave jonike të rrjeshtit dytë disa karakteristika lokale, që i shquajnë ato nga shtyllat e të njejtit stil të përdorura në botën tjetër greke. Ornamentet në formë



kërmilli të stilit jonik kanë tek shtyllat e portikut origjinë bimore e marrin trajtën e një luleje në formë hinge. Pjesa e mbuluar me çati, që zinte gjysmën e sheshit, shërbente për ta strehuar popullin kur binte shi ose kur rrezet e diellit ishin tepër përvëluese. Tre shtatna të mermertë të zbuluar gjatë gërmimeve përpara kamareve tregojnë se në të 17 kamaret ishin vendosur skulptura të njerëzve të çuar të kohës për ti nderuar në këtë mënyrë për meritat e tyre. Sheshi në tërësinë e tij kishte formën e një terrace 75 metra të gjatë dhe 12 metra të gjërë, që shihte nga jugu. Si kohë, ndërtimi i portikut i përket shek. IV para erës së re, por vazhdoi të jetë në përdorim edhe gjatë gjithë kohës romake. Shtatnat prej mermeri që u zbuluan përpara kamareve, janë për shëmbull, të kohës romake.


Ngjitur me portikun, nga lindja, u zbuluan edhe një tok kamare të tjera diçka më të mëdha, të cilat në kohë romake u përdorën për qëllime të ndryshme apo u ngritën mbi to godina të tjera. Këto kamare lidheshin arqitektonikisht me sistemin e portikut dhe kishin përpara vetëm një rrjeshtë shtyllash të stilit dorik. Ndërmjet çdo kolone kishte veç kësaj bazamente të formave dhe madhësive të ndryshme të cilat, si dhe kamaret e portikut, mbanin përsipër shtatna të ndryshëm personalitetesh, ndër të cilët në kohën e sundimit romak mbizotronin shtatnat e perandorëve ose të miseve të familjeve të tyre. Për fat të keq në periudhën e vonë antike, kur qyteti i Apollonisë kishte marrë tatëpjetën ekonomike për arsye të kontradiktave t'ashpra që kishin shpërthyer në gjirin e shoqërisë skllavopronare dhe të ndërrimit të shtratit të Vjosës, që e la qytetin pa liman, të gjitha këto shtatna, sikurse e tregoi një lëmë e madhe zjarri e mbushur me thërrime mermeri e zbuluar në gërmime, u transformuan në gëlqere.

Diçka më vonë se monumentet arqitektonike të përmëndur, që i përkasin afërsisht shek. IV para erës së re, u ngrit muri i rrethimit të kodrës mbi të cilën ishte ndërtuar tempulli i Artemisit. Teknika e ndërtimit është një lloj si tek kamaret, por gurët janë më të vegjël, shenjë e një periudhe më të vonë ndërtimi, që e daton murin në periudhën helenistike d.m.th. mbas vdekjes së Lekës së Madh. Muri që ka për detyrë kryesore të mbështesi masat e dheut të kodrës, pra ka më tepër karakter ornamental se sa mbrojtës, përshkohet nga një portë, e cila nuk përfundon me një qemer të vërtetë, që nuk njihej ende në këtë kohë, por me një qemer të rremë i arritur tue afrue gurët njëni me tjetrin. Prej kësaj porte të shpie lart në kodër, d.m.th. në tempull, një rruginë e ngushtë dhe e përpjetë e kufizuar më të dy krahë nga mure. Kanale të posaçme të veshura sipër, poshtë dhe



anash me rrasa të mëdhaja gurësh, zbrisnin nga kodra dhe përcillnin ujët e shiut në duqe guri, që përshkonin murin në shumë pika. Prej këndeje ujët e shiut kalonte në një kanal më të madh grumbullues, i cili e shpinte këtë jashtë mureve rrethues të qytetit.

Përgjithësisht sistemi i kanalizimit ishte shumë i zhvilluar në Apolloni, gjë që në vetë vetëhe tregon nivelin e lartë ekonomik e kultural të qytetit. Por edhe vetë karakteri kodrinor i Apollonisë ku rrëketë, që zbrisnin nga sipër mund të bëheshin të rrezikëshme për qytetin e poshtëm në rrasa shkarkimesh të mëdha resh, i impononte qytetit ndërtimin e një rrjeti të tërë kanalesh. Një kanal i madh, i caktuar për mbledhjen e këtyre ujrave, u zbulua në skanjën perëndimore të sheshit të madh që u përshkrua më sipër. Ky kanal, i veshur krejt me gur të mëdhenj është aq i madh sa lejon të kaloj nën të, i kurrusun, një njeri i rritur.



Pamje nga muri rrethues i qytetit të përshkuem nga një grykë kanali.

Edhe gjatë sundimit romak zemra ekonomike dhe kulturele e Apollonisë përqëndrohej për rreth sheshit dhe kolonadës me shtylla dorike që përmëndëm më sipër. Këtu ishin godinat kryesore zyrtare dhe jo larg prej këtej pak më nga veriu shtrihej me sa duket edhe lagja e paanikëve, që kishin pushtetin në dorë. Por në këtë pikë nuk





Shtat mermeri i grabitur nga italkanët.

janë bërë ende gërmime. Godina e parë e madhe pranë portikut, nga lindja e tij, është një theatër i vogël, dikur i mbuluar me çati. Këtu nuk kemi theatrin kryesor të qytetit, i cili duhet të ketë qënë jo vetëm disa herë më i madh por edhe i hapët d.m.th. i pambuluar me çati. Tek kjo godinë e mbështetur me shpinë rrëzë të një kodre, pra të rrethuar me mure vetëm nga të tri anët, ne shohim një sallë ku inteligjenca e qytetit, oratorët, filosofët, poetët, mbanin biseda, konferenca ose recitonin nga veprat e tyre. Në rrjeshtat e shkallëve, dikur të mveshura krejt me mermër ashtu si dhe faqet e mbrëndëshme të krejt godinës, rrinin dëgjuesit, kurse konferencieri e kishte vëndin poshtë tek sheshi i vogël në formë gjysëm rrethi ose tek tribuna e vogël, që ngrihej ndërmjet kësaj dhe murit. Si në theatrot ashtu edhe këtu ngjitja nëpër vëndet kryhej nëpërmjet dy shkallëve të ngushta, që kalonin në rrëzë të mureve dhe të një shkallë të tretë, që e ndante në dy gjysma vëndin e ndejeve. Godina kishte tri porta dy të vogla për anësh dhe një të madhe, me një palë shkallë të gurtë, në ballë. Muret, që rrethojnë theatrin janë ndërtuar me tulla të mëdha të pjekura mirë e të lidhura me llaç gëlqereje. Kjo teknikë d.m.th. përdorimi i llaçit të gëlqeres dhe i tullave është karakteristikë për ndërtimet e kohës romake.

Pranë theatrit, përbri portës së vogël perëndimore, ndodhej një faltore e vogël, ku kryheshin lutje para se të hyhej në theatër; se kujt nga të 12 perënditë kryesor i kishte qënë kushtuar kjo faltore, për të cilën ishte përdorur një kamare e madhe më e mocme, nuk dihet për arsye se mbrënda sajë u gjetën vetëm tri bazamentet por asnjë nga shtatnat që mbanin këto përsipër. Gjetja këtu pranë e një veshi dhe një thundre kali, që të dyja prej bronxi, tregojnë se njëri prej shtatnave të vendosur mbi bazamentet i përkiste një kalorësi por asgjë më tepër. Për fat të keq kjo faltore me dy nga bazamentet, me hajatin e sajë të shtruar me rrasa të mermerta dhe me hyrjen e bukur të stolisur me shtylla jonike apo korinthike ishte një ndër monumentet, që prishën vandalët nazistë duke i shndërruar në strehime antiajrore.

Gjithnji pranë theatrit, pak metra në jugë lindje të tij, gërmimet nxorrën në shesh një godinë tjetër të ndërtuar prej tullash të kualitetit shumë të mirë, gjë që do të thotë se edhe kjo ndërtesë i përkiste shekujve të parë të perandorisë romake. Gjatë gërmimeve nuk u gjet këtu asnjë skulpturë, asnjë mbishkrim as edhe ndonjë objekt tjetër që të na ndihmonte të dinim se për çfarë kishte shërbyer kjo ndërtesë. Që kemi të bëjmë edhe këtu me një ndërtesë me karakter zyrtar dhe jo me një të tillë private, kjo kuptohet nga ambienti d.m.th. nga godinat e tjera zyrtare që ngrihen për rreth sajë. Edhe kolonada me shty-



lla dorike, që kalonte para portës së sajë të vetme, që shihte nga përrëndimi (në drejtim të theatrit të vogël dhe portikut) flet për një gjë të tillë. Se për çfarë përdorësh kjo ndërtesë ngjan të na e tregojë një parvas i gjërë që e përshkonte kthinën e madhe të ndërtesës nga brënda, nga tri anë. Ky parvas kujtohet të ketë shërbye për të mbajtur dollapë librash dhe në qoftë se ky mendimi i ynë është i vërtetë atëhere kemi të bëjmë me një arshivë apo bibliotekë të qytetit. Por duhet të kemi parasysh se librat antike kishin formën e rrypave të gjatë letrash (të nxjerra nga papyri, një lloj kallami që rritej në brigjet e Nilit) ose pergameni (lëkurë e punuar) të rrotulluar në for-



Bust mermeri, punuar në shek. II. t'ërës re.




më cilindrike. Shtresa e ngritur e godinës mbështetëj pjesërisht mbi një nga kamaret e mëdha, që zbukuronin dikur sfondin e kolonadës të formuar prej shtyllash dorike.

Ndërtesa e tretë zyrtare, që ngrihej po këtu afër (nja 20 metra në jugë të theatrit) dhe që formonte një tërësi arkitektonike por edhe kulturele së bashku me theatrin e vogël dhe me bibliotekën, ishte ashtuquajturë monument i agonotetëve, i cili e mori këtë emër nga një mbishkrim për të cilin do të flasim më poshtë. Monumenti i agonoteteve ishte një pallat i vërtetë. Edhe në gjëndjen e saj të soçme në gërmadha godina le tek vizituesi një përshtypje të fortë. Të lënë sidomos përshtypje blloqet e mëdhenj guri të bardhë gëlqeror, që janë përdorur në fasadën e tij të jashtme drejtuar nga veri-lindja. Fasada mbështetëj mbi gjashtë shtylla mermeri (katër të mezit të plota dy të anës gjysma shtyllash) të stilit korinthik. Shtyllat vetë qëndronin mbi një hajat, tek i cili hyej nëpërmjet një palë shkallëve të gurta, që kishin gjërësinë e vetë fasadës së ndërtesës. Arhitravi i gurtë, që mbanin shtyllat përsipër, nga ana e poshtëme ishte i zbukuruar me breza gjethesh të skulpturuara, kurse në faqe mbante një mbishkrim në gjuhë të vjetër greke, me gjithëse ndërtesa vetë i përket shekujve të parë të perandorisë romake. Kjo nuk duhet të na çudisi mbasi e thamë edhe më sipër se Apollonia, me gjithëse ndodhej nën sundimin romak, mundi të ruaj edhe mbaskëndej një farë vetëqeverimi. Një ndër këto privilegje ishte pikërisht përdorimi i gjuhës greke në vënd të latinishtes, që përdorej si gjuhë zyrtare pothuajse në të gjitha vëndet e pushtuar nga Roma.

Mbi arhitrav peshonte një kornizë e zbukuruar pasurisht me ornamente bimore të skulpturuara me një kujdes e mjeshtëri, që i bënë nder skulptorëve të panjohur apollonias. Të gjitha i kurorëzonte një faqe trekëndëshe muri, mbi të cilën ishte hedhur çatia e mbuluar me tjegulla. Muret e tjera të ndërtesës ishin ngritur, si zakonisht në shekujt e parë të perandorisë romake dhe veçanërisht në vende të variëra në material guri, siç ishte rasti i Apollonisë, me tulla. Godina kishte një kthinë të vetme ku hyej nga porta e vetme, që lidhej me hajatin. Përmbrenda kthina ishte pajisur me një lloj sofaje artificiale dhe në formë gjysmë rrethi të mbështetur në shpinë mbi mure tullash të lidhura me llaç gëlqereje. Mbi këtë sofa ishin vendos, gjithnjë në formë gjysmë harku si në theatrot, rrjeshta ndejesh të veshura me pila-ka mermeri të cilat, kur ndërtesa filloi të rrënohet, u shkulën nga vëndi për tu përdorur gjetiu. Lidhur ngushtë me kthinën kryesore janë edhe dy kthina shumë të vogla që ndodhen në shpinë të sofasë dhe, që lidhen me kthinën kryesore me anën e dy rruginave të ngushta





Paraqitja skulpturale e nji perëndie pyelli, Silenit.





Nji vazo e mrekullueshme e shek. VI, para e. r. grabitur nga fashistët më 7 prill 1939.



të mbuluara dikur me qemër, të cilat kalojnë ndërmjet mureve të sofasë dhe mureve t'anëshme të monumentit t'agonotëve.

Përse shërbente kjo ndërtesë monumentale e ndërtuar në qendrën e qytetit? Nuk mund të ketë dyshim se edhe kjo nuk ishte private por kishte karakter të përgjithshëm me gjithse mbishkrimi i skulptur me shkronja të bukura mbi fasadën e saj, na thotë se shpenzimet e ndërtimit të këtij pallati nuk u paguan nga arka e qytetit por nga një person i vetëm. Mbishkrimi ka këtë përmbajtje: E ndërtoi Quintus Vilius Krispinus Furius Prokulus, prytan, agonotet dhe kryepriift (i Apollonisë) për të nderuar kujtimin e vllajt të tij Villius Valentinus Furius Prokulus, prefekt i togës x në Siri, tribun i legionit y në Panoni (Ungari të sotme) dhe i propozuar për Agonotet. Për inaugurimin u dha një çfaqje me 25 çifte gladiatorësh.

Ndërtuesi i përkiste parisë së naltë të qytetit ku ai kishte ushtruar funksionet më të larta civile e fetare dhe kishte qënë edhe agonotet d.m.th. organizatori kryesor i lojnavë dhe festave si dhe kryepriift i emëruar për gjithë jetën, kishte pasë pra tre nga funksionet më të rëndësishme, që i ushtrojshin vetëm njerëz të shtresave të pasura të qytetit. Ai e ndërtoi këtë godinë për të nderuar kujtimin e të vllajt, që kishte shërbye si oficer i lartë në garnizonet ushtarake romake të Sirisë e Panonisë, në fillim si komandant bataljoni dhe më vonë si i tillë i një legioni, që do t'i përgjigjej regjimentit tonë të sotëm. Ai u propozua në këtë ndërkohë për agonotet n'Apolloni por me sa duket vdiq në mërgim. Për inaugurimin e ndërtesës u bë, simbas mbishkrimit, një festë e madhe, në të cilën muerën pjesë 25 çifte gladiatorësh; ndeshjet e gladiatorëve ia përngjanin afërsisht ndeshjeve të sotme të boksit, me ndryshimin se përfundimet ishin këtu zakonisht të përgjakëshme dhe shpesh vdekje-prurëse, mbasi rivalët nuk mateshin me shoqi-shoqin me grushta por luftonin me thika ose shpata të vogla. Përsa i përket shkallës shoqërore gladiatorët ishin në përgjithësi skllevër, përsa i përket kombësisë nga ana tjetër ilirë ose thrakas. Spartaku, që drejtoi me kaq guxim e trimëri kryengritjen e madhe të skllevërve në Romë, bënte pjesë pikërisht në këtë kategori lojnash, që çmoheshin shumë nga romakët.

Mbi godinën vetë d.m.th. se për ç'qëllim shërbente monumenti i agonotëve, mbishkrimi hesht fare. Tue qënë se një godinë me një planimetri krejt të njëlojtë nuk njihet as në botën tjetër antike, arkeologët ndodhen para një problemi të vështirë dhe janë të detyruar të manovrojnë me supozime. Mendimi, që mbizotëron është se tek monumenti i agonotëve duhet të shohim një odeon, një sa-



llë për çfaqje muzikore por nuk përjashtohet mundësia që të ketë shërbyer edhe si Buleuterion, seli e këshillit të qytetit. Kjo pasiguri është shkaku që kjo godinë vazhdon të quhet si monument i agnotetëve.

Ndërmjet tri ndërtesave të përshkruara shtrihej një shesh i vogël me një hark triumfal me tri porta. Të tilla harqe janë lidhur me emrin e një personi të shquar, kryesisht me emrin e një perandori për nderimin e të cilit ngriheshin; harku i Apollonisë, i cili nuk është ruajtur veçse tepër i gjymtuar dhe i çveshur nga pllakat e mermerta dhe reliefet, që e zbukuronin, nuk dijmë se cilin nga perendoret ndëronte. Do t'ishte më afër mendjes sikur t'i ketë qenë kushtuar Augustit, perandorit të parë, i cili sikurse e pamë sipër, kishte studjuar në këtë qytet.

Nga ana e lindjes monumenti i agnotetëve kufizohej me një rrugë relativisht të gjërë për konditat antike, mbasi rrugët e qyteteve antike në përgjithësi ishin shumë të ngushta, rrallë i kalonin tri metrat. Rruga, që kalonte pranë monumentit t'agonotetëve dhe përshkonte harkun triumfal, kishte edhe një trotuar mjaft të gjërë. Në krahnun tjetër të rrugës vazhdonte kolonada, prapa së cilës në shekujt e fundit të pushtimit romak, pra në kohën e rënjes ekonomike të qytetit, u ndërtuan disa dyqane të vegjël, në muret e të cilëve përdoren materiale të marrur nga ndërtesa të tjera të lëna jashtë përdorimit. Pikërisht këto materiale ndërtimi të marrun andej këndeve ndihmuan për ti datuar këto dyqane, të varfër nga pikëpamja e pajisjes arqitektonike, të ndërtuar në kohën kur Apollonia kishte marrë tatëpjetën si qendër ekonomike dhe si qytet.

Mbi këmbën e mezit të harkut triumfal është vendosur një gur i skalitur në formë predhe topi. Ky është një obelisk, një nga simbolet tipike të perëndisë Apollon, pra edhe t'Apollonisë. Obelisku zbukuronte edhe disa tipe monetash bronzi e argjendi të prera në këtë qytet. Nëse obelisku i zbuluar pranë harkut triumfal, ka pas qënë vendos në kohnat antike në majë të këtij harku apo mbi një bazament, që u gjet para murit të terracimit, që kufizonte nga jugu kodrën me tempullin e Artemisit, nuk mund të thuhet me siguri.

Nja njëqind metra në jugë-perëndim të shëtitores dolën në shesh edhe gërmadhat e dy shtëpijave banimi, të cilat në planimetrinë e tyre nuk kanë asnjë ndryshim nga banesat e përdorura në botën tjetër të kulturës greko-romake. Shtëpitë lidhen me rrugën nëpërmjet të një rrugine të ngushtë, nuk kanë pra nga rruga veçse mure. Të gjitha kthinat janë rrjeshtuar për rreth një hajati, që e



merr dritën nga një baxhë e madhe e lënë hapur mbi çati. Ujët e shiut, që binte nga strehët e çatisë, mbledhej në një hanz të hapur në mez të hajatit dhe përcillej së këtejmi, me anë të një kanali, jashtë.

Themelet e një shtëpije tjetër u zbuluan në Apolloni në vjetin 1940, në kohën e okupacionit fashist të Shqipërisë. Por kjo shtëpi



Nji vazo me sqenë mythologjike, punuar në shek. IV. para e. r.



ndryshon nga tipi i përgjithëshëm i shtëpive të Apollonisë për arsye se në planimetrin e saj i është përshtatur një godine më të lashtë mbi të cilën është ndërtuar, një gjimnaz. Gjimnazet antike ndërtesa me oborre të gjërë, hajate dhe banja, shërbenin në fillim për stërvitje fizike të trupit por më vonë përdoreshin edhe për edukimin mendor të rinisë. Gjimnazet tona janë pasardhës dhe trashëgimtar të drejtë për drejtë pikërisht të këtij institucioni kultural antik.

Një problem i vërtetë për Apolloninë ishte furnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë. Burimet natyrale ishin të pakët dhe me ujë të pamjaftuarshëm për të furnizuar një qytet të madh si Apollonia. Sjellja e ujit prej së largu, për arsye të vështirësive teknike të pakapërxyeshme, paraqitej për Apolloninë një problem jo aq i lehtë se sa ishte për Durrësin, që e sillte ujin e pijshëm, ashtu si në kohën tonë deri në vjetin 1958, nga Erzeni dhe Butrinti nga mali i Milesë. Qytetarët e Apollonisë ishin detyruar prandaj të çilnin një tok puse mbrënda territorit të qytetit. Puse të tillë janë gjetur disa në Apolloni, njëri nga ato ndodhet në shpinë të monumentit të agonotetëve, një tjetër, që nuk shterret as në stinat ma të thata të vitit, disa dhjet metro më nga perëndimi. Puset janë veshur fund e krye me tulla dhe kanë gryka prej gurësh të skalitur.

Shumë interesante është teknika e ndërtimit të mureve rrethojnës të Apollonisë, të cilët sikurse e cekëm sipër, kishin një gjatësi prej më se katër kilometra dhe një gjërësi prej rreth 2,50 m. Për arsye se materiali i gurtë (rreth 100.000 metro kub), që nevojitej për ndërtimin e këtij muri rrethojnës, duhej të sillej së largu, ishte lidhur pra me mundime e shpenzime të rënda, arqitektet menduan ta zëvendësojnë një pjesë të materialit ndërtues me tulla, që nuk përdoreshin për këtë qëllim në kohët e lashta veçse shumë rrallë. Deri në një lartësi prej tri metrash muri rrethojnës i Apollonisë është ndërtuar prandaj me gurë dhe pjesa e sipërme, d.m.th. 5-7 m., me tulla. Gurët, të skalitur me mjeshtëri, kanë një gjatësi normale prej 0,60 m. por janë përdorur edhe të tillë, që arrijnë një gjatësi prej 2 m. Tullat nga ana tjetër kanë formë katrore me brinj 0,38 m. dhe me një trashësi prej 8 cm. Si tullat ashtu edhe gurët janë lidhur me një teknikë të thatë d.m.th. janë vendosur njeri mbi tjetrin pa përdorur asnjë mjet ndërlidhës qoftë llaç gëlqereje apo shtrese balte. Qëllimi kryesor i ngritjes së murit rrethojnës të Apollonisë ishte mbrojtja e qytetit nga sulme eventuale dhe të befasishme nga armiq të jashtëm. Për ta ngritur fuqinë mbrojtëse të tyre, mureve rrethojnës nuk u jepej një planimetri e caktuar, por ngriheshin zakonisht



në majë të faqeve të rrëpirta të pllajave, mbi të cilat shtrihej qyteti. Një forcim tjetër i mureve arrihej nëpërmjet të kullave katërkëndëshe ose të rrumbullakta, që vendoseshin në pika të ndryshme të murit rrethonjës, më të shpeshta n'ato pika ku mbrojtja natyrale d.m.th. rrëpirta nuk ishte dhe aq e pjerrët ose muri kalonte në terren fushor.



Paraqitje skulpturale e Vjosës.

Në përgjithësi muri ekzistonjës i Apollonisë kujtohet të jetë ngritur në shek. IV para erës së re, por ka disa trakte muri, që tregojnë një vjetërsi më të lashtë dhe të tjerë, që të shpien në një kohë më të vonë. Muri i bukur i zbuluar në vitin 1956, i përket p.sh. një periode shumë më të vonë se shek. IV para erës së re. Ky mur i zbuluar në një gjatësi prej 25 m. është ruajtur në një lartësi prej rreth pesë metrash. Pjesa e poshtme e gurtë është këtu shumë më e ulët se sa tek muri i shek. IV-të. Tullat janë jo vetëm më të mëdha (6 cm. më të gjata e të gjëra) por janë lidhur ndërmjet tyre me shtresa llaçi,



teknikë kjo karakteristike për një kohë më të vonë, për periudhën e pushtimit romak.

Muri për të cilin folëm e përshkonte edhe një grykë kanali, që shërbente për të përcjellë jashtë qytetit ujrën e shiut të faqes jugore të kodrës, që mbante përsipër tempullin e Artemisit; ndoshta përfundonin këtu edhe rrëqe të tjera, që mbledhnin ujrën e theatrit, t'odeonit e të godinave të tjera aty pranë. Gryka e kanalit, që përshkon pjesën e tulltë të murit, është veshur krejt me gur si nga jashtë ashtu edhe përmbrënda dhe ka një pjerrësi prej 45 gradësh. Ka formën e një katërkëndëshi dhe mbaron sipër me hark. Ujë të derdhej mbi një shtresë rrasash me anën e një duqi të zgavruar në formë lugu. Si nga pikpamja teknike ashtu edhe nga pikpamja e bukurisë formale gryka e kanalit është një vepër e përsosur arqitektonike dhe i bën nder mjeshtrëve apollonias.


Pak ma sipër nga ky mur u zbuluan themelet e një muri tjetër të ndërtuar në kohët e vona të sundimit romak, kur muri i vjetër, i nxjerrur prej kohësh jashtë përdorimit dhe mbuluar nga haliqet dhe plehurat e hedhura nga popullsia, nuk dukej më. Ky mur i ndërtuar me ngutësi të madhe për arsye të një reziku që i kërcënohej Apollonisë, por që burimet historike nuk e përmendin fare, nuk ka asnjë mjeshteri në ndërtimin e tij dhe është ngritur me materiale të dorëpërdorëta të mbledhura andej këndeve ose të nxjerrura nga gërmadha godinash të afërta.

Vorrezat apo nekropoli (qyteti i të vdekurve) i Apollonisë mbulonte një territor mjaft të gjërë dhe shtrihet jashtë mureve të qytetit si nga lindja ashtu edhe nga perëndimi i qytetit. Katundi i soçëm i Kryegjatës dhe pjesa më e madhe e luginës së bukur që shtrihet deri në Radostinë, ishte mbuluar gjatë shekujve me vorre. Vorreza të tjera të Apollonisë ndodhen nën arat e Kooperativës bujqësore të Pojanit.

Të vjetrit, qofshin grekë apo ilir, besojshin në një jetë të dytë mbas vdekjes prandaj i ndërroshin shumë të vdekurit e tyre. Ato u jepnin të vdekurve me vetëhe sendet më të çmueshme që kishin patur për zemër kur ishin të gjallë, fëmijëve lojnat prej balte të pjekur, metali ose fildishi apo ndonjë hajmal, femrave objekte zbukurimi si mbas moshës së tyre dhe enë të ndryshme toaleti apo përdorimi, kurse burrave kryesisht armë të ndryshme si shpata, thika, maja heshtash e shigjetash, përkrenare, por nuk mungojnë dhe enët prej balte si gypat për venë, kandila vaji etj.

Nga vorret e zbuluara në Apolloni ne dimë se ishin në përdorim dy zakone vorrimi: mënyra e vorrimit me gufoma dhe mënyra ku





Monument vorri kushtuar Parmeniskut (shek. III-të para e. r.).



trupi i të vdekurit digjej dhe eshtrat e bëra shkrumë bashkë me hinin kalleshin në një qyp të vogël e mandej varroseshin. Në kohërat më të vjetra mbizotronte zakoni i varrimit në gufoma, por gufoma nuk vendosej gjithnjë mbi dhe. Në shekujt VI-V para erës së re gufomat e të vdekurve i gjejmë të vendosura në qypa të mëdhenj me grykë të gjërë, që ia përgjajnë magripave tonë të vajit. Gjithë në këtë qyp, të cilit i mbulohej gryka me një rrasë të madhe guri, i jepeshin të vdekurit peshqeshet, ose të thomi më drejtë sendet që i duheshin në botën tjetër. Mënyra e dytë e varrimit, që përdorej në dy shekujt e parë të themelimit t'Apollonisë ishte shumë më e kushtueshme: gufoma vendosej e shtrime në shpinë, në një arkë të madhe (sarkofag) guri, që mbulohej me një kapak guri në formë çatije. Pranë gufomës rrjesh-toheshin peshqeshet, vlefta e të cilave varej nga pozita shoqërore e të vdekurit. Një pjesë e madhe e këtyre varreve më të hershme të Apollonisë janë mbuluar përsipër me një grumbull të lartë dheu, që kap shpesh herë një lartësi prej 2-3 metrash. Këto lloj varresh, të njohur në arkeologji me emrin latin tumulus, nga e cila rrjedh edhe fjala tumë, që përdoret në disa krahina të Shqipërisë për të tilla çuka t'izoluara, janë të huajtura nga ilirët, të cilët këtë lloj varrimi monumental e kishin trashiguar qysh nga koha e bronzit dhe vazhduan ta përdorin deri nga fundi i kohës romake. Në shek. IV në Apolloni gjejmë edhe varre monumentale të ndërtuar me gur të mëdhenj e të skalitur bukur. Këto kishin formën e një shtëpie të vogël 2-3 m. të gjatë dhe një deri 1.1/2 të gjërë të mbuluar sipër në formë çatije. Një vorr i tillë i përkiste natyrisht, gjë që vërtetohet edhe nga sendet me vleftë, që përmbante (vaza më e bukur e muzeut arkeologjik-etnografik të Tiranës, e pikturuar në mënyrë artistike me skena mitologjike e figura të tjera njerëzore u gjet pikërisht në këtë vorr), një pasaniku d.m.th. shtresave të larta sundonjëse të qytetit.

Në varret e kohërave më të vona përdoren gjërësisht tullat dhe tjegullat. Gropa katërkëndëshe e varrit rrethohet zakonisht në të katër anët me mure t'ulët tullash, që kanë të njëjtat permasa si ato të mureve të rrethimit të qytetit. Varri mbulohej mandej me dhoga dhe sipër tyre hidhej dheu. Tek varret me tjegulla nuk ka mure. Gropa katërkëndëshe e varrit rrethohet në të katër anët me tjegulla, të cilat në kohë antike ishin të sheshta dhe shumë të mëdha. Edhe mbulesa e sipërme e këtyre tip varreve formohej po nga tjegulla. Tek varret e shekujve të parë para erës re dhe veçanërisht n'ato të kohës romake tjegullat e mbulesës vendosen mbi gufomë në formë çatije.

Në vazhdim të gjërmimeve sistematike por edhe në gjetje rasti si në punime bujqësore, në çeljen e kanalit Levan-Fier etj. u zbuluan mbrënda kufijve të qytetit dikur të lulëzuar të Apollonisë me mijëra





Nji vazo tjetër e tipit korinthik (shek. VI.) grabitur nga fashistët italian.



objekte si shtatna perëndishë e njerzish, reliefe, shtylla, kapitete e pjesë të tjera arkitektonike, mbishkrime me përmbajtje të ndryshme, gur varresh të shtresave të ndryshme nga më të pasurit deri tek më të vobektit e skllëverit, me qindra enë balte me ose pa pikturime, të punuara me një teknikë, gusto artistike dhe formë elegante, që duhen t'i kenë zili keramistët tonë të sotëm; me qindra e mijra janë edhe sendet e tjera t'artizanatit, që janë zbuluar n'Apolloni dhe, që mbushin sot sallat e fondet e muzeut arkeologjik të Tiranës dhe muzet lokale të Fierit dhe të Pojanit. Ndër të një vend me rëndësi zënë monetat e zbuluara në gjermime dhe ato të gjetura nga fshatarët, të cilat kapen në mijra dhe nuk përfshijnë vetëm moneta të prera në punishtet e Apollonisë por edhe të tilla pare, që erdhën n'Apolloni nëpërmjet tregëtisë.

Të gjithë këto objekte të zbuluara qofshin ndërtesa apo sende të lëvizëshme, na flasin me gjuhën e tyre dhe janë në gjëndje të na tregojnë, mjafton që ne ti kuptojmë drejtë dhe metoda e gjermimit të jetë shkencore, një tok gjëra mbi jetën e qytetit dhe të popullsisë, mbi zhvillimin ekonomik, shoqëror, kultural, artistik e historik të tij dhe na lejojnë kështu të kemi një pasqyrë sa më të plotë mbi të shkuarën e këtij qyteti më të madh antik të vendit tonë duke na zëvendësuar ose plotësuar kështu atë që nuk na e thonë apo na e japin të paplotë burimet e shkruara historike. Duhet të shtojmë këtu vetëm, dhe kjo ka rëndësi të madhe, se gjermimet e Apollonisë ndodhen ende në fillim; asht gjermuar vetëm një pjesë shumë e vogël e qytetit antik dhe mbetet ende shumë për të bërë.

Sivjet gjermimet arkeologjike të Apollonisë do të hyjnë në një fazë të re. Në vend të 30-40 punëtorëve dhe një kohë prej maksimumi dy muajësh që ka pasë qënë gjermuar deri më sot, do të angazhohen këtë vit prej Maj deri në Korrik, d.m.th. për 3 muaj rjesht, jo më pak se 200 punëtorë. Ajo që ka më shumë rëndësi është se këtë vit do të marrin pjesë në gjermimet tona edhe një ekip prej tetë arkeologësh të njohur sovjetikë, ndihmë kjo shumë e çmueshme pse do të na japi mundësinë të njihemi me metodën më të re të gjermimeve, që është garancia më e mirë për një punë shkencore të përpiktë në lëmin e studimeve arkeologjike. Nuk ka pra as dyshimin më të vogël se gjermimet e sivjeçme në Apolloni do të pasurojnë edhe më tej fondet e muzeve tona me materiale të çmueshme arkeologjike dhe për pasojë edhe njohurit tona mbi të shkuarën e kësaj qendre të rëndësishme kulture të kohërave të lashta.